

Simpoziumi i EUROSAT-t mbi Çështjet Emergjente me temë “Impakti në mjedisin ekonomik të shpenzimeve publike”

U zhvillua në datat 30-31 tetor 2023 në Lisbonë, Simpoziumi i EUROSAT-t mbi Çështjet Emergjente me temë “Impakti në mjedisin ekonomik i shpenzimeve publike”.

Simpoziumi u organizua në kuadrin EUROSAT me partnerë Gjykatën e Auditimit të Portugalisë dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar.



Fokusi kryesor i këtij simpoziumi trajtoi mënyrën se si ndryshimi i mjedisit ekonomik po ndikon në shpenzimet publike, duke parë rritjen e kostove të huamarrjes dhe masat që duhet të marrin qeveritë e vendeve europiane për përballimin e këtyre ndryshimeve, në përshtatjen e strukturave buxhetore sa më efikase dhe të pranueshme, me impakt në mbështetjen e shtresave sociale që preken më shumë nga këto ndryshime, veçanërisht në fushën e arsimit,

shëndetësisë dhe mbështetjes ekonomike.

Gjithashtu u diskutua mbi presionet e kostos inflacioniste, ndryshimet demografike dhe praktikatat e mira në qëndrueshmërinë financiare, rekomandimet dhe cilat janë masat që marrin qeveritë qendrore që në hartimin e PBA-ve. U vu theksi tek përgjegjësitë e SAT-t për të audituar këto procese të ndikuara nga çështjet e reja që po u dalin shteteve si nga krizat ekonomike, por dhe nga kërkesat e vazhdueshme për kontributin e qeverive në mbrojtjen e mjedisit dhe përballimin e emergjencave mjedisore.

Temë me rëndësi ishte dhe ajo mbi pasojat e borxhit dhe inflacionit në menaxhimin e buxheteve publike, rrugët për minimizimin e ndikimit të tyre në ndryshimin e strukturave buxhetore dhe masat që duhet të merren për mbajtjen nën kontroll, ashtu si dhe detyrat që u dalin SAT-ve për auditimin e menaxhimit të buxheteve shtetërore e mos rritjen e borxhit publik.



Kompleksiteti i të kuptuarit të pasigurisë dhe qëndrueshmëria e financave publike në vlerësim të situatave emergjente apo kërkesave të menjëhershme, ishte temë që u trajtua nga pjesëmarrësit në panele diskutimi duke e vënë theksin tek ndikimi i SAT-ve në qeveritë e tyre për menaxhimin e pasigurisë dhe qëndrueshmërisë së financave publike.

Përfaqësuesit e KLSH-së morën pjesë në panelet e diskutimit duke dhënë kontribut në evidentimin e konkluzionit kryesor se, SAT-t duhet të kenë objekt auditimi ndryshimet e fundit ekonomike në auditimet e performancës, për të analizuar faktorët që kanë ndikuar dhe raportin me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030. Kjo i jep vlerë SAT-it në rekomandimet për qeverinë, veçanërisht në politikatat fiskale dhe shpenzimet, hartimin e projektbuxhetit apo alokimet që duhet të bëhen në periudhën 2024-2025. Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë aktivitet u përfaqësua me z. Bajram Lamaj, auditues i lartë dhe z. Sali Hiraj, auditues i I.